




Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare
Ministarstvo za Rad, Porodicu i Vrednosti Oslobodilačkog Borbe
Ministry of Labour, Family and Values of the Liberation War

Kabineti i Ministrit,



Datë: 15.06.2026

Ministri për Punë, Familje dhe Vlerat e Luftës Çlirimtare në mbështetje të paragrafit 1.5 të nenit 11 të Ligjit 08/ L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, paragrafit 3 të nenit 36 të Ligjit nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare, nenit 3, 4 dhe 7 të Rregullores së MD-së nr. 08/2024, për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit Profesional për Shërbime Sociale dhe Familjare, nenit 8 të Rregullore (QRK) - Nr. 04/2026 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Ministrive, nxjerr këtë:

VENDIM Nr. 39 / 2026

1. Themelohet Këshilli Profesional për Shërbime Sociale dhe Familjare me këtë përbërje:
 - 1.1. Blerim Shabani, anëtar, Ganimete Shala zëvendës anëtarë, nga MPFVLÇ
 - 1.2. Nafije Selimi, anëtare, Liridon Sadiku zëvendës anëtarë, nga MPFVLÇ
 - 1.3. Magbule Koci, anëtare, Shqipe Prekaj zëvendës anëtarë, nga MPFVLÇ
 - 1.4. Lutfi Bislimi, anëtar, Ilir Mazreku zëvendës anëtarë, nga MPFVLÇ
 - 1.5. Prof. Avdyll Gashi, anëtar dhe Anton Vukpalaj, zëvendës anëtar nga Universiteti,
 - 1.6. Liridon Aliu, anëtar dhe Fata Rexhepi Mehmeti, zëvendës anëtarë nga Organizatat Joqeveritare,
 - 1.7. Ardita Hyseni, anëtar dhe Amir Bushi, zëvendës anëtar nga Qendrat për Punë Sociale.
2. Këshilli ka kompetenca sipas Ligjit nr. 08/L-255 për Shërbime Sociale dhe Familjare, Rregullores së MD-së Nr. 08/2024, për Organizimin dhe Funksonimin e Këshillit Profesional për Shërbime Sociale dhe Familjare si dhe akteve të tjera ligjore ne fuqi.

3. Mandati i anëtarëve të Këshillit është katër (4) vjeçar.
4. Me këtë vendim shfuqizohet vendimi nr. 384/2024 i datës 07/11/2024 i Ministrisë së Drejtësisë.
5. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Vendimi iu dërgohet:

- Anëtarëve të Këshillit;
- Kabinetit të Ministrit të MPFVLÇ-së;
- Zyrës së Sekretarit të Përgjithshëm të MPFVLÇ-së;
- DPSHSF/ MPFVLÇ dhe- Arkivës së MPFVLÇ-së.